

Bota në Shkatërrim*

Ylli Përmeti**

“Lëmshi” Global në një Shikim (*Volumi i Parë*)

Ndërsa “kriza shumë-dimensionale” globale po përkeqësohet, në Francë, lëvizje “revolucionare” po avancon. Fundi i kapitalizmit dhe ardhja e “ultra-majtistëve”, ata deklarojnë, duhet të vi, me Nouveau Parti Anti-Capitaliste (NPAC) të jetë pjesë e furtunës globale. “Deklarimi” Trockist është “truku” i tyre. Ndërkohë, Grekët, Irlandezët, Portugezët, Italianët dhe Gjermanët –të të gjitha moshave, janë pjesë e kryengritjeve europiane, me Londinezët, të cilët kanë adoptuar një sjellje anti-sistemike, kundër, jo vetëm masave të tanishme, të ndërmarra nga partia e tanishme konservatore, por gjithashtu, kundër të pasurve, duke e quajtur, “black block”. Njëkohësisht, Lindja e Mesme, gjëndet në luftë dhe rebelim revolucionar dhe Perëndimi po mundohet të zgjerojë demokracitë tona të aplikuara nga *lart-poshtë*, duke luftuar me ushtrinë e kapitalit, duke vrarë njerëz të pafajshëm dhe duke shkelur sovranitetin e popullit, në Libi. Të gjëndur në këtë botë kundër-thënëse, reminishenca jonë shkon pas në kohë dhe sjell vitet e Ravolucionit Francez (1789-1799), i cili udhëhiqesh nga *klasa e pasurisë së paluajtshme, industrisë e mëdha, dhe klasa e bankierëve*. Rrjedhimisht, duke patur prelud këtë periudhë, dhe të mësuar me këto kryengritje në Europë, të rinjtë e globit, janë “këmbana e alarmit” sërish.

Si rrjedhim, “shpiksja” e Sistemit Monetar European–Britania, përpara shpërthimit të krizës së tanishme globale, ishte duke zgjidhur shkatërrimin e ekonomisë, duke iu falur Zotit për ndihmë: Tony Blair, “Papa” i ri ka deklaruar dashurinë e tij, për Zotin, dhe është duke u munduar të qetësojë situatën, duke dhënë ligjëratat rreth globit me qëllim që të bindë popullin, se zgjidhja është ‘atje jashtë’...duke inaguruar fatalitetin e Obamës dhe duke thënë se: ‘besimi duhet të rivendoset në vendin e vet, si udhërrëfyes i botës dhe i të ardhmes sonë’. Për më shumë, Blair donte të bëhesh President i UE–pa

rregulluar si fillim ekonominë e Britanisë—pavarsisht se ai futi nocionin e ‘socializmit demokratikë’ ose ‘liberalizmit radikal’ në “revolucionin” e tij politikë. Me të vërtetë, Blair donte të nxirrte klasat jashtë politikës Britanike dhe njëkohësisht krijoi një nga fluskat më të mëdha në historinë kapitaliste dhe një orgji të konsumit të shfrenuar. Përballë tij, kritiku i atashuar i New York Time-s, Paul Krugman, vashdon t’i bier alarmit se ekonomia Amerikane po shkon në një grackë deflacioniste dhe është në buzë të katastrofës—dhe natyrisht, asnjëri nuk mund të parashikojë shkatërrimin galopant të botës sonë!

Ky pothuajse “deflacion total” është kritikuar rëndë këto ditë nga një ndër komentatorët më konservatorë në amerikë, Rush Limbaugh: drejtimi i rrjedhës politike që Obama po përdor është bipartizan, ai tha, midis të tjerash. Të gjëndur në këtë dritë të errët, Ministri i Mbrojtjes i SHBA-së, Robert Gates, sa i përket Iranit, tha, se “opsioni ushtarak” duhet të mbahet mbi tavolinë. Këto aludime tipike fashiste kundërmojnë gjithë kohën në mediat tona! Në anën tjetër, të demostrososh sot asnjëri nuk ka mundësi: Lordi Mandelson, Ministri e Tregëtisë Britanike, nën mbretërinë Laburiste, u tha demonstruesve të papunë, në Britani, për të shkuar në Europë për të gjetur punë!

Falimentimet individuale janë një tjetër patate e nxehtë, duke rritur numrin e punëtorëve më shumë se 50%, dhe paratë publike në Britani po shpëtojnë bankat. Në fjalë të tjera: **të shoqërizosh humbjet dhe të përvetësosh fitimet**. Paratë e paprekshme, janë një tjetër truk i superelitës: Japonia që nga viti 2007, është duke përdorur pará elektronike—duke ngatërruar dhe çuar ekonominë (e cila është gabim sidoqoftë) në greminë. Dukshmërisht, gjoja “antagonizmi” midis udhëheqesve, në Europë, dhe në vende të tjera, është i qartë: Sarkozy kritikoi homologun e tij Brown për politika të gabuara dhe marrëdhëniet midis dy vendeve janë anakronikisht duke u përkeqësuar.

Ky “antagonizëm” është pjesë e lojës; pa të—s’do të kishte thashethemnaja “elitare” në media! Si rrjedhojë e këtij antagonizmi, udhëheqësi e konservatorëve, i cili kohët e fundit, u zgjodh kryeministër i Britanisë, David Cameron, merr drejtimin e vendit të vet (2010), duke përdorur sloganin e “big society”, e cila duket se do të realizohet si më parë—që është, ‘shoqëria e madhe’ përcakton pushtetin por jo racionalitetin!

Duhet të kujtojmë, në këtë pikë, aksiomën Flyvbjergiane sa i përket racionalitetit të një qeverie: pushteti [popull] përcakton se çfarë vlen për racionalitet dhe njohuri dhe si rrjedhim se çfarë vlen për

realitet; duke nënkuptuar se, *konteksti* i një çështje politike dhe ekonomike përcakton cilin pushtet do të pushtetonte dikush [njerëzit e zakonshëm]; jo distanca, sikurse Cameron e nënkupton atë; për këtë arsye, Cameron, vazhdon të ruaj të njëjtin pushtet dhe ai nuk ndryshon aplikimin e racionalitetit; ai ndryshon thjesht sloganin!

Sidoqoftë, është e sigurtë që politikat e shekullit 21 do të vazhdojnë të ndryshojnë slogane dhe jo politika dhe racionalitet!

Kështu, pas gjithë këtyre kundërthënieve orëzeza, të bazuar në mediat tona—medët, bankat globale nuk kanë më pará për të huazuar te kreditorët. Rrjedhimisht, sikurse i theksua në kapitullin e parë, (*Gracka e Turit*) dhe sikurse do të analizohet në vazhdim të këtij kapitulli, borxhet publike janë një tjetër ‘kaskadë’ e vendeve perëndimore, duke u kanosur nga një rritje e madhe debiti më shumë se 100% të PBB-së, duke u ndeshur me një rrezikshmëri të popullsisë që po mplaket shumë shpejt. Si rrjedhojë, të ardhurat e qeverive do jenë më të ulëta dhe shpenzimet më të larta, duke e bërë konsolidimin shumë më të vështirë. Ky realitet sidoqoftë, i përket ekonomisë së sotme; tjetra, është se ‘mplakja e popullsisë’, mund të zgjidhet nga demokracitë dhe ekonomitë tona (*shih kuadrin tonë që propozojmë në vazhdim*), por qeveritë, duan të mbajnë *status quo*-në e tyre, nën sistuatën e tanishme, e cila është një situatë, ‘totale monopolizuese kaotike globale’.

Rrjedhimisht, sa herë që një vend përballet me probleme të tilla, me qëllim që t’i përballojë ato, ai duhet të gjejë fronte të tjerë për përfitim dhe konservim; këto fronte zakonisht janë luftrat globale! Kjo është arsyeja që luftrat e NATO-s vazhdojnë të avancojnë. Kjo është arsyeja që “Rendi e Ri Global” nuk mund të ndalojë demarshin e tij. Kjo është arsyeja që “revolucionin” politikë i Obamës është duke mbështetur manipulimin e medias, në favor të korporatizimit dhe hegjemonisë Amerikane, sikurse kohët e fundit u zbulua, nga “kokona çudibërëse” me qëllim që të përhapin propagandë proamerikane. Kjo është arsyeja që kriza e pashmangshme do të përkeqësohet. Kjo është arsyeja, që pabarazitë sociale u prezantuan, të cilat sikurse u përshkruan nga Guardian—po përkeqësohen më shumë se kurrë, në historinë Britanike.

Por përse? Është kjo e gjitha e asaj çka duket apo është diçka tjetër që shqetëson ithtarët e “*Qeverisë së Re Globale*”? Kjo do jetë rrjedhimisht pyetja jonë kryesore të sulmojmë në këtë kapitull.

Gjithashtu, ky kapitull do të mbrojë vdekjen e demokracive sociale, luftrat për burimet natyrale, shkatërrimet e pyjeve, zhdukjen e specieve, ngrohjen globale, dhe natyrisht qorrsohakun e ekonomisë sonë globale. Ky qorrsohak mund të vërtetohet sot më shumë se kurrë. Rrjedhimisht, si fillim, le të marrim një shije të situatës së tanishme, pavarësisht kundërthënies të mësipërme; më poshtë kemi paraqitur shkurtimisht disa nga studimet e fundit dhe problemet që njerëzimi ose **politikat universale** kanë shkaktuar, deri më sot, në biodiversitetin tonë global:

Historikisht, humbjet natyrale të biodiversitetit shkaktoheshin me një përqindje mjaft më të ngadaltë dhe përballoheshin me lindjen e specieve të tjera. Sot, përqindjet e zhdukjeve janë vlerësuar të jenë 100 deri në 1,000 herë më shpejt sesa ato në kohët gjeologjike. Ndjekja e humbjeve të tanishme nga Indeksi i Gjallesave të Planetit (orjentim) dhe IUCN Lista e kuqe (rrallësi) ofrojnë gjithashtu tablo të zymta të situatës. Një numër specimesh tokësore, detare dhe ujë të freskët janë në rënie konstante dhe numri i specieve globale në kërcënim është rritur në mënyrë konstante në dhjetë vitet e fundit. Vlerësimet e fundit në Listën e kuqe (IUCN 2009) tregojnë se:

1. Pothuajse njëçerek (22%) e gjitarëve global dhe një e treta (32%) e specieve amfibë janë zhdukur dhe kërcënohen në nivel global;
2. Rreth një e treta dmth, 3,481 specie nga numri total që është përshkruar në 30,700 specie janë në rrezik;
3. 12% e shpendëve global janë nën rrezik;
4. Niveli më i lart i kërcënimit është gjendur në ishujt e disa vendeve; 39-64% e gjitarëve janë kërcënuar nga Mautitët, ribashkimi dhe i Seselëve 80-90% i specieve amfibë janë në rrezik ose në zhdukje në ishujt Karaibe.

Në po të njëjtin studim, dikush mund të gjejë shkatërrimin e pamasë të mëmës tokë, në numra, grafikë dhe fotografi. Dhe kjo punë është quajtur nga arkitektët e disiplinës, “Ekonomia e Ekosistemit dhe e Biodiversitetit”. Dhe ky është thjesht një zë tjetër që po i bie këmbanës se alarmit për arkitektët e ekonomisë së tanishme dhe veçanërisht për politikanët e qeverisë globale, të cilët janë, **elita transnacionale e mbështetur nga korporatat globale**. Kjo orvatje është një tjetër ri-vlerësim i situatës së tanishme për të cilën dikush mund të gjej rrugë se si të shmang vendime të gabuara në politikë-bërje.

Sidoqoftë, nëse ne zgjerojmë këndvështrimin tonë, mbi globin tonë –sa i përket rritjes së temperaturës, e shkaktuar nga rritja e CO2 në atmosferë, e cila është rezultat e shoqërive tona konsumeriste pafrë–ne duhet të shtrojmë një pyetje shumë të thjeshtë: si krahasohet ndryshimi i klimës së shekullit të 21 me 2,000 vitet e

kaluar? Është shumë e mundshme se përqindjet mesatare të rritjes së CO₂, gjithashtu edhe në kombinime forcash rrezatuese nga CO₂, CH₄ dhe N₂O ku përmbledhja rritet, kanë qënë të paktën pesë herë më shpejtë rreth periudhës nga viti 1960 deri 1999 sesa rreth çdo lloj 40-vjeçari tjetër përgjatë dy mileniumeve të fundit para erës industriale. Për më shumë, sikurse një vëzhgues me vend identifikon: është konsumerizmi që ka përmblytur atmosferën me CO₂: zotërimi konstant dhe shpenzimi, ku \$1 i shpenzuar çliron afërsisht 1lb karbon. Ne po rikundim globin, dhe shpejt ne po qorrollepsemi në një formë të vetme të menduar rreth katastrofave, ku as Zoti as natyra, por njeriu është për t'u akuzuar. Që nga momenti që ajri i ngrohtë mban më shumë avuj uji sesa i ftohti, atmosfera është pothuajse 5% më e lëngët sesa ajo ishte disa dekada më parë. Kjo hedh zaren e pëmblytjeve të mëdha të llojit befas dhe kaq të gjithëgjëndshme. Amerikanët djegin më shumë karbon për person sesa çdokush tjetër; çfarë mund t'i thuash atëherë një fermeri Pakistani i cili vështron farmën dhe punën e tij të gëlltitet nga furtunat?

Mbrojtshmërisht, dhe si rezultat i 'shoqërisë karbon-konsumeriste', shkencëtarët kanë arritur të dokumentojnë humbjen e 492 specieve në Angli, pjesa më e madhe e tyre janë zhdukur që nga fillim-vitet 1800. Informacioni për humbjet nga studimet më të mira zbulojnë: 24% e fluturave, 22% e amfibëve, 15% e delfinëve dhe balenave, 14% e bargurorëve, 12% e gjitarëve tokësor dhe 12% e insekteve guror janë zhdukur nga Anglia. Kjo është thjesht një pjesë e pasqyrës së ekosistemit Anglez; imagjino vende të tjerë rreth globit (!); pjesa më e madhe e tyre nuk kanë "informacion" të situatës së sotme.

Në anën tjetër, patatja më e nxehtë i kolapsit tonë qëndron te energjia: sipas studimit të Heinberg, kulmi i naftës dhe rrjedhimish i energjisë do të vi përgjatë dekadës së parë së shekullit 21.

Kolapsi atëherë, do të ndodh menjëherë kur e gjithë bota (nëse) do të inkorporohet në kërkesën e paferenuar të naftës: dhe kjo është kështu ngaqë, "**kërkesa është në rritje dhe prodhimi në zëbritje**", duke kanosur 'varferinë energjitike' në një rritje të rrezikshme, për të cilën kompani private, në Britani, bëhen më të pasura, sepse heqin qafe vdekjet; dhe natyrisht arsyeja kryesore e kësaj, sipas një studimi të fundit, është sepse kontrolli i publikut mbi kompanitë energjitike, të cilat janë privatizuar dhe bëjnë kapital nga varfëria e njerëzve, është shumë i dobët! Kështu, mbështetja globale në energji të rinovueshme ose energji fosile si psh, qymyr, naftë dhe gas natyral mbetet burimi i më shumë se 80% për të gjithë kërkesën parësore energjitike, duke iu shtuar energjia nukleare me vetëm 6%. Energjitë e

ri-novueshme janë burimet e së ardhmes por mbeten të varura nga subvencionet dhe rregullimet. Ato ende furnzojnë më pak se 2% të nevojave globale - një figurë kjo që do të rritet në shifrën më optimistike në 7% pas vitit 2035.

Në të njëtin sektor të energjisë, ka shumë elementë për t'u diskutuar, për këtë çështje: kompani naftë, sikurse BP etjsikëto, pas manipulimit të naftës rreth globit, kanë shkaktuar katastrofa serioze në mjedis; por pasoja më serioze është se ata nuk dinë se si të pastrojnë gjëmën e tyre, kur ata provokojnë katastrofa sikurse është ajo e Deepwater Horizon, e cila shpërtheu në Golfin e Meksikës, pas një sërë shpërthimesh të së njëjtës forcë shkatërruese rreth botës, sikurse në të kaluarën. Lëndët plastike lundruese, të prodhuara nga industritë tona, sikurse u dokumentuan në oqeanin Atlantik Verior, është një shkatërrim tjetër e burimeve tona planetare, duke shkaktuar shfarrosje të peshqve dhe pasuritë natyrale të planetit tonë. Rrjedhimisht dhe pa asnjë dyshim, kjo katastrofë mund të quhet “humbje të shumëfishta në dëm të natyrës sonë dhe përfitim privat”, në favor të kompanive tona shumë-kombëshe, dmth kapitalit oligark.

Ndaj, nëse dikush do të zgjerojë shkatërrimin e planetit tonë, do të ishte ide e mirë të lexojë dhe të studjojë të gjithë këto studime. Dhe kjo, për një arsye shumë të thjeshtë: ne po dëshmojmë një nga katastrofat më të mëdha të shkaktuar ndonjëherë në historinë tonë humane. Pjesa më e madhe e këtyre studimeve janë mjaft profesionale dhe të detajuara. Por pika më e rëndësishme është se ata të gjithë ndjellin katastrofa. Nëse, në anën tjetër, ne duam të jemi të sigurtë për ekonominë tona dhe *mullarët me kapital*, pavarisht kasaphanës cituar më lartë, ne mund të shtojmë konkludimet vijuese të ekonomistit dhe themeluesit të GlobalResearch, Michel Chossudovsky:

Kjo krizë është shumë më tepër serioze se ajo e Depresionit të Madh. Të gjithë sektorët kryesor të ekonomisë globale janë afektuar. Fabrika po mbyllen. Linjat e montimit janë në pikë të vdekur. Papunësia është e papërmbajtur. Pagat janë shkatërruar. Popullime masive janë shtyrë në varfëri shumë të thellë. Mjetet e jetesës janë shkatërruar. Shërbimet publike janë prishur ose privatizuar. Pasojat e jetës së njerëzve në Veriun Amerikanë dhe rreth botës janë dramatike.

Rrjedhimisht, kapitalizmi, në formën që ai është sendërtuar, ka falimentuar; jo vetëm ekonomikisht por edhe eko-gjeologjikisht. Dhe ai ka falimentuar sepse ekonomia jonë është përmbysur sëprapthi. Kështu, nuk është vetëm pushteti i parásë që ka përmbysur ekonominë

tona por gjithashtu dhe ‘institucionet tona globale’, të cilët drejtonë, zhysin dhe vulosin përmes spekulimeve të ardhmen e një vendi. Ata mund t’ua zhysin një ekonomi të një vendi sepse ata kurrë nuk mund të masin rendimentin e një ekonomie duke ndenjur përpara monitorëve të tyre dhe duke vendosur disa masa artificiale të bazuar në dollar dhe duke bërë kështu, ata përjashtojnë ekonominë reale të një vendi, ose të një lokaliteti, e cila, sikurse do t’i qasemi më vonë, nuk mund të matet me parate që një vend prodhon. Kështu, kapitalizmi sikurse e njohim, është fundosur në vrimën e tij, i cili është drejtuar atje, nga vet natyra e tij. Ndaj, është në natyrën e tij të dështoj, sepse pikërisht, ai është i përmbysur. Sikurse një ithtar tjetër ravijëzon:

Të gjithë idhujt e kapitalizmit përrreth dekadave të kaluar u copëzuan. Hemendjet dhe presupozimet, paradigma dhe prognoza të progresit papërcaktim nën tregun kapitalist liberal janë testuar dhe kanë dështuar. Ne po jetojmë fundin e një epoke të tërë: ekspertë gjithandej dëshmojnë kolapsin e SHBA-së dhe të sistemit financiar global, mungesën e kreditit për treg dhe mungesën e financimeve për investime. Një depresion botëror, në të cilin më shumë se një çerek e forcës së punëtorëve botëror do jenë të papunë, po kanoset.

Trishtueshëm, si rezultat e kapitalizmit të sotëm, ne po humbasim pandërprerje dhe me shpejtësi biodiversitetin tonë total, duke përfshirë mikroorganizmat e tokës, planktonin në oqeanë, pjalmuesit dhe pyjet e mbetur tropikal dhe të kursyer. Kjo konsolidon toka produktive, ujë të pastër, rregullim klime dhe rezistencë-sëmundjesh. Ne i konsiderojmë këto shërbime vitale për biodiversitetin dhe ekosistemin të sigurt, i trajtojmë ato pakujdes dhe nuk i përfshijmë në ndonjë përlllogaritje kombëtare. Si fundi, uji i tokës, i cili zë më shumë se 72% të sipërfaqes së saj, është ndotur rrezikshmërisht dhe ne rrezikojmë si shoqëri të goditemi dramatikisht nga sëmundje dhe epidemi. Këto janë, disa nga problemet madhore që njërëzimi ka shkaktuar deri më tani te Toka jonë.

Sidoqoftë, le t’i bëjmë një re-vlerësim situatës, nga një kënd-vështrim tjetër; nga ajo që quhet nga arkitektët dhe politikanët tanë “profesional”—‘monetarizëm dhe ekonomi’. Ne do konfrontojmë rrjedhimisht përgjatë këtij kapitulli vlerë-racionalitetin kundër racionalitetit instrumental. Kështu, në zemër të këtij “konfrontimi” do jetë ekonomia jonë globale. Ndaj, ne do të analizojmë—(edhe një herë), ekonominë e së kaluarës dhe të tanishmet, dhe në fund, ne do të vendosim në rend ‘ekonominë’ tonë, sa i përket natyrës dhe implikimeve të saj. Pra le të udhëtojmë bashkë brenda saj.

*Kjo është pjesa e parë e kapitullit të Platformës Globale ‘Fronetikë dhe Demotikë Manifesto’, e cila shoqërohet me një analizë-kritikë të ekonomive, politikave dhe filozofive globale dhe në fund prezanton një kuadër filozofiko-politiko-ekonomik si ndoshta rrugëzgjdhja e vetme nga kolapsi global të shkaktuar nga kapitalizmi monetar, universalizmi ideologjik dhe revanshi hegjemonist amerikan. Pasi trajton tendencën e kapitalizmit tonë në nivel tekniko-filozofikë dhe individët që e dominojnë atë filozofikisht, shkon dhe trajton në më shumë se 40 faqe hegjemonizmin si koncept, me amerikanën si udhëheqëse, e cila në kuadër të një hegjemonizmi fashist tipik shpik një mori trukesh dhe manierash për të shtënë në dorë burimet natyrale të globit, pasi shteroi të sajat, që në vitet 1970. Lexuesi apo studjuesi, mund të kryqëzojë informacion me kapitullin origjinal i cili është i shkruajtur në anglisht, por nuk është emetuar ende i revizionuar, ku janë detajuar shumë subjekte të tjerë. Gjithashtu, mund të kryqëzojë informacion me **Përtej Ekonomisë së Tregut dhe Planit Shtetëror: Drejt një Ekonomi dhe Demokraci Fronetike**, ku do të gjejë një pjesë të vogël të asaj që ky projekt propozon. Por edhe të gjitha analizat e tjera, të cilat janë plotësuese në kompletimin e tablosë globale. Ky kapitull shoqërohet edhe me dy kapituj të tjerë: në të parin, kritikë të shkencave politike dhe sociologjike dhe në të tretin, kritikë kushtetutave dhe ligjeve, duke propozuar edhe rrugëzgjdhjen ndoshta të vetme.

Autori është bashkë-themelues i LDSH-së (Lëvizje për Drejtësi e Shqiptarëve) dhe në pamundësi për të shkruajtur në median shqiptare, për arsye çensure nga këta të fundit (!), shkruan në një ndër gazetat më prestigjioze globale: **The International Journal of Inclusive Democracy, ku bashkë me disa akademikë, të kudondodhur, kundërshton sistemin e tanishëm, si nevojë emergjente për globin, demokracinë dhe ekosistemin tonë global. Kjo gazetë, publikohet katër herë në vit dhe themeluesi i saj është Takis Fotopoulos, i cili është ndoshta i vetmi që ka prezantuar një Platformë konkrete filozofiko-ekonomiko-politike që në vitet 1996 (Përtej Chomsky-it dhe Flyvbjerg). Tashmë kjo gazetë shpërndahet në metropolet më të rëndësishëm global: Londër, Uashington, Kinë etj. Ndërkohë, Fronetikë dhe

Demotikë Manifesto, kongludon po aty, ku Fotopoulos kongludon, por me ndryshime në detaje dhe në plan, por që rezultati është i njëjtë. Të dyja si platforma janë racionale (përtej Marksit dhe Aristotelit) liri-mbartëse, liberale, autonome, ekologjike, feministike dhe natyrisht të qëndrueshme.

Mbetet, që njerëzit e devotshëm, human dhe të ndërgjegjshëm t'a adoptojnë.

Mirë se erdhët në epokën e Republikës Racionale dhe Liberale.